FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

HALOPERIDOL

Pika për gojë, tretësirë – 0.2 % (2 mg / ml)

(Haloperidol)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.
- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ju shfaqet ndonjë efekt anësor, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj. Kjo përfshin edhe efektet anësore që nuk përmenden në këtë fletëudhëzues. Shih pikën 4.

Në këtë fletëudhëzues:

1. Çfarë është Haloperidol dhe përse përdoret?
2. Përpara se të merrni Haloperidol
3. Si ta merrni Haloperidol?
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Haloperidol?
6. Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË HALOPERIDOL DHE PËRSE PËRDORET
Haloperidol i përket një grupi të barnave të quajtur "antipsikotikë".
Haloperidol përdoret tek të rriturit, adoleshentët dhe fëmijët për sëmundje që ndikojnë në mënyrën si mendoni, ndiheni ose silleni. Këto përfshijnë probleme të shëndetit mendor (siç është skizofrenia dhe çrregullimi bipolar) dhe probleme të sjelljes.

Këto sëmundje mund t'ju bëjnë të:
- ndiheni të hutuar (delir);
- shihni, dëgjoni, ndjeni ose nuhatni gjëra që nuk janë aty (haluçinacione);
- besoni gjëra që nuk janë të vërteta (deluzione);
- ndiheni jashtëzakonisht dyshues (paranoja);
- ndiheni shumë të eksituar, të axhituar, entuziastë, impulsivë ose hiperaktivë;
- ndiheni shumë agresivë, armiqësorë ose të dhunshëm.

Tek adoleshentët dhe fëmijët, Haloperidol përdoret për të trajtuar skizofrenينë për pacientët e moshës nga 13 deri në 17 vjeç, dhe për të trajtuar problemet e sjelljes për pacientët e moshës nga 6 deri në 17 vjeç.

Haloperidol përdoret gjithashtu:
- tek adoleshentët dhe fëmijët e moshës 10 deri në 17 vjeç dhe tek të rriturit që bëjnë lëvizje ose tinguj që nuk mund t'i kontrollojnë (tike), p.sh. në sindromën Tourette të rënduar;
- tek të rriturit për të ndihmuar kontrollin e lëvizjeve në sëmundjen e Huntington.

Haloperidol përdoret ndonjëherë kur barnat ose trajtimet e tjera nuk kanë funksionuar ose kanë shkaktuar efekte anësore të papranueshme.

2. PËRPARA SE TË MERRNI HALOPERIDOL
Mos merrni Haloperidol nëse:
- jeni alergjik ndaj haloperidolit ose ndonjërit prej përbërësve të tjerë të këtij bari (renditur në pikën 6);
- jeni më pak të vetëdijshëm për gjërat që ju rrethojnë ose reagimet tuaja bëhen jashtëzakonisht të ngadalta;
- keni sëmundjen e Parkinsonit;
- keni një lloj demence të quajtur "demenca me trupat e Lewy-s";
- keni paralizë supranukleare progresive (PSP);
- keni zgjatje të intervalit QT, ose ndonjë problem tjetër me ritmin e zemrës që tregohet si një gjurmë anormale në EKG (elektrokardiogramë);
- keni pamjaftueshmëri të zemrës (insufiçiencë) ose kohët e fundit keni kaluar një atak kardiak;
- keni nivel të ulët të kaliumit në gjak, i cili nuk është trajtuar;
- merrni ndonjë nga barnat e renditura në pikën "Marrja e barnave të tjera - Mos merrni Haloperidol nëse po merrni barna për".

Ky bar nuk duhet të përdoret nëse mendoni se keni ndonjë nga gjendjet e përmendura më sipër. Nëse nuk jeni të sigurtë, flisni me mjekun ose farmacistin përpara se të merrni Haloperidol.

Tregoni kujdes të veçantë me Haloperidol
Efektet anësore serioze
Haloperidol mund të shkaktojë probleme në zemër, probleme me kontrollin e lëvizjeve të trupit ose të gjymtyrëve dhe një efekt anësor serioz të quajtur "sindroma neuroleptike malinje". Mund të shkaktojë gjithashtu reaksione të rënda alergjike dhe mpiksje gjaku. Duhet të jeni të vetëdijshëm për efektet anësore serioze ndërsa jeni duke marrë Haloperidol sepse mund të keni nevojë për trajtim mjekësor të menjëhershëm. Shih "Tregoni kujdes për efektet anësore serioze" në pikën 4.

Të moshuarit dhe njerëzit me demencë
Një rritje e vogël e vdekjeve dhe insulteve është raportuar për të moshuarit me demencë të cilët marrin barna antipsikotikë. Flisni me mjekun ose farmacistin përpara se të merrni Haloperidol nëse jeni i moshuar, veçanërisht nëse keni demencë.

Njoftoni mjekun ose farmacistin nëse keni:
- rrahje të ngadalta të zemrës, sëmundje të zemrës ose ndonjë nga familjarët tuaj të afërt ka vdekur papritur nga problemet e zemrës;
- presion të ulët të gjakut, ose keni marramendje kur çoheni nga pozicioni shtrirë në pozicionin ulur ose kur çoheni në këmbë;
- nivel të ulët të kaliumit ose magnezit (ose ndonjë 'elektroliti' tjetër) në gjak; mjeku do të vendosë se si ta trajtojë këtë;
- patur ndonjëherë gjakrrjedhje në tru, ose mjeku ju ka thënë që keni më shumë mundësi sesa njerëzit e tjerë të keni insult;
- epilepsi ose keni patur ndonjëherë kriza (konvulsione);
- probleme me veshkat, mëlçinë ose gjendrën tiroide;
- nivel të lartë të hormonit 'prolaktinë' në gjak, ose kancer që mund të shkaktohet nga nivele të larta të prolaktinës (siç është kanceri i gjirit);
- histori të mpiksjes së gjakut, ose dikush tjetër në familjen tuaj ka një histori të mpiksjes së gjakut;
- depresion, ose keni çrregullime bipolare dhe filloni të ndjeni depresion.

Mund të keni nevojë të monitoroheni më nga afër, dhe doza e Haloperidol që merrni mund të duhet të ndryshohet.
Nëse nuk jeni të sigurtë nëse keni ndonjë nga gjendjet e përmendura më sipër, flisni me mjekun ose farmacistin përpara se të merrni Haloperidol.

Kontrollet mjekësore
Mjeku mund të dëshirojë të bëjë një elektrokardiogramë (EKG) përpara ose gjatë trajtimit tuaj me Haloperidol. EKG mat aktivitetin elektrik të zemrës.

Analizat e gjakut
Mjeku mund të dëshirojë të kontrollojë nivelet e kaliumit ose magnezit (ose ndonjë 'elektroliti' tjetër) në gjak përpara ose gjatë trajtimit tuaj me Haloperidol.

Fëmijët nën moshën 6 vjeç
Haloperidol nuk duhet të përdoret tek fëmijët nën 6 vjeç. Kjo për shkak se nuk është studiuar sa duhet në këtë grupmoshë.

Marrja e barnave të tjera
Njoftoni mjekun ose farmacistin nëse po merrni, keni marrë kohët e fundit ose mund të merrni ndonjë bar tjetër.

Mos merrni Haloperidol nëse merrni barna për:
- probleme me ritmin e zemrës (si: amiodaroni, dofetilidi, disopiramidi, dronedaroni, ibutilidi, kinidina dhe sotaloli);
- depresion (si citaloprami dhe escitaloprami);
- psikoza (si: flufenazina, levomepromazina, perfenazina, pimozidi, proklorperazina, promazina, sertindoli, tioridazina, trifluoperazina, trifluromazina dhe ziprasidoni);
- infeksione bakteriale (si: azitromicina, klaritromicina, eritromicina, levofloksacina, moksifloksacina dhe telitromicina);
- infeksione mykotike (si pentamidina);
- malarie (si halofantrina);
- të përziera dhe të vjella (si dolasetroni);
- kancer (si toremifeni dhe vandetanibi).

Gjithashtu, njoftoni mjekun nëse po merrni bepridil (për dhimbje në gjoks ose për të ulur presionin e gjakut) ose metadon (për dhimbje ose për të trajtuar varësinë nga droga).
Këto barna mund të favorizojnë problemet e zemrës, kështu që flisni me mjekun nëse po merrni ndonjë nga këto dhe mos merrni Haloperidol (shiko "Mos merrni Haloperidol nëse").

Monitorimi i veçantë mund të jetë i nevojshëm nëse merrni litium dhe Haloperidol në të njëjtën kohë.

Njoftoni menjëherë mjekun dhe ndaloni marrjen e të dy barnave nëse ndiheni:
- me ethe që nuk mund t'i shpjegoni ose bëni lëvizje që nuk mund t'i kontrolloni;
- të hutuar, të çorientuar, me dhimbje koke, keni probleme me ekuilibrin dhe ndiheni të përgjumur.

Këto janë shenja të një gjendjeje të rëndë.

Disa barna mund të ndikojnë në mënyrën se si vepron Haloperidol ose mund të favorizojnë problemet e zemrës

Njoftoni mjekun nëse po merrni:
- alprazolam ose buspiron (për ankth);
- duloksetinë, fluoksetinë, fluvoksaminë, nefazodon, paroksetinë, sertralinë, lulebasani *(Hypericum, perforatum)* ose venlafaksinë (për depresion);
- bupropion (për depresion ose për t'ju ndihmuar të ndaloni pirjen e duhanit);
- karbamazepinë, fenobarbital ose fenitoinë (për epilepsi);
- rifampicinë (për infeksione bakteriale);
- itrakonazol, posakonazol ose vorikonazol (për infeksione mykotike);
- tableta ketokonazol (për të trajtuar sindromën Cushing);
- indinavir, ritonavir ose sakuinavir (për virusin HIV);
- klorpromazinë ose prometazinë (për të përziera dhe të vjella);
- verapamil (për presionin e gjakut ose probleme të zemrës).

Gjithashtu njoftoni mjekun nëse po merrni ndonjë bar tjetër për të ulur presionin e gjakut, siç janë shkarkuesit (diuretikët).
Mjeku mund të duhet të ndryshojë dozën e Haloperidol nëse ju merrni ndonjë nga këto barna.

Haloperidol mund të ndikojë në mënyrën e veprimit të barnave të mëposhtëm

Njoftoni mjekun nëse merrni barna për:
- qetësim ose që ju ndihmojnë të flini (qetësues);
- dhimbje (barna kundër dhimbjeve të forta);
- depresion ('antidepresivë triciklikë');
- uljen e presionit të gjakut (të tilla si guanetidina dhe metildopa);
- reaksione të rënda alergjike (adrenalinë);
- çrregullimin e deficitit të vëmendjes dhe hiperaktivitetit (ADHD) ose narkolepsinë (të njohur si 'stimulantë');
- sëmundjen e Parkinsonit (siç është levodopa);
- hollimin e gjakut (fenindion).

Njoftoni mjekun përpara se të merrni Haloperidol nëse merrni ndonjë nga këto barna.

Marrja e Haloperidol me ushqim dhe pije
Konsumimi i alkoolit ndërsa jeni duke përdorur Haloperidol mund t'ju bëjë të ndiheni të përgjumur dhe më pak vigjilent. Kjo do të thotë që duhet të keni kujdes me sasinë e alkoolit që pini. Flisni me mjekun nëse konsumoni alkool dhe tregojini sasinë që konsumoni ndërsa merrni Haloperidol.

Shtatzënia
Nëse jeni shtatzënë, mendoni se jeni shtatzënë ose po planifikoni të keni një fëmijë, këshillohuni me mjekun. Ai mund t'ju këshillojë të mos merrni Haloperidol gjatë periudhës që jeni shtatzënë.
Problemet e mëposhtme mund të ndodhin tek foshnjet e porsalindura të nënave që marrin Haloperidol në 3 muajt e fundit të shtatzënisë (tremujori i fundit):
- dridhje e muskujve, ngurtësim ose dobësim i muskujve;
- përgjumje ose axhitim;
- probleme me frymëmarrjen ose ushqyerjen.

Frekuenca e saktë e këtyre problemeve është e panjohur. Nëse keni marrë Haloperidol gjatë shtatzënisë dhe foshnja juaj zhvillon ndonjë prej këtyre efekteve anësore, kontaktoni mjekun.

Ushqyerja me gji
Njoftoni mjekun nëse ushqeni me gji ose planifikoni të ushqeni fëmijën me gji. Kjo për arsye se sasi të vogla të barit mund të kalojnë në qumështin e nënës dhe tek fëmija. Mjeku do t'ju tregojë mbi rreziqet dhe përfitimet e ushqyerjes me gji gjatë kohës që jeni duke marrë Haloperidol.

Fertiliteti
Haloperidol mund të rrisë nivelin e një hormoni të quajtur 'prolaktinë', i cili mund të ndikojë në pjellorinë tek burrat dhe gratë. Flisni me mjekun nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me këtë.

Drejtimi i automjeteve dhe përdorimi i makinerive
Haloperidol mund të ndikojë në aftësinë tuaj për të drejtuar automjetin dhe përdorur mjete ose makineri. Efektet anësore të tilla si përgjumja, mund të ndikojnë në vigjilencën tuaj, veçanërisht kur filloni ta merrni barin ose pasi keni marrë një dozë të lartë. Mos drejtoni automjetin ose mos përdorni mjete ose makineri pa e diskutuar më parë këtë me mjekun.

Informacione të rëndësishme mbi disa nga përbërësit e Haloperidol
Ky bar përmban metil hidroksibenzoat dhe propil hidroksibenzoat, të cilët mund të shkaktojnë reaksione alergjike (ndoshta të vonuara).

3. SI TA MERRNI HALOPERIDOL
Gjithmonë merreni këtë bar siç ju ka thënë mjeku ose farmacisti. Flisni me mjekun ose farmacistin nëse nuk jeni të sigurtë.

Sasia e barit që duhet të merrni
Mjeku do të vendosë dozimin dhe kohëzgjatjen e marrjes së Haloperidol. Mjeku gjithashtu do t'ju tregojë nëse duhet të merrni Haloperidol një ose më shumë herë në ditë. Mund të kalojë pak kohë para se të ndjeni efektin e plotë të barit. Normalisht në fillim të mjekimit mjeku do t'ju japë një dozë të ulët, dhe pastaj do të rregullojë dozën që ju përshtatet. Është shumë e rëndësishme që të merrni dozën e saktë.

Dozimi i haloperidolit do të varet nga:
- mosha juaj;
- gjendja për të cilën jeni duke u trajtuar;
- fakti nëse keni probleme me veshkat ose mëlçinë;
- barnat e tjera që merrni.

1 ml tretësirë = 20 pika = 2 mg.

Të rriturit
- Doza juaj normalisht do të jetë ndërmjet 0.5 mg dhe 10 mg çdo ditë.
- Mjeku mund ta rregullojë këtë për të gjetur dozën që ju përshtatet më së miri.
- Doza më e lartë që duhet të marrin të rriturit varet nga gjendja për të cilën janë duke u trajtuar dhe varion midis 5 mg dhe 20 mg çdo ditë.

Të moshuarit
- Të moshuarit normalisht do të fillojnë me 0.5 mg çdo ditë ose me gjysmën e dozës më të ulët të të rriturve.
- Doza e Haloperidol që merrni do të rregullohet derisa mjeku të gjejë dozën që ju përshtatet më së miri.
- Doza më e lartë për të moshuarit është 5 mg në ditë, përveç rasteve kur mjeku vendos një dozë më të lartë.

Fëmijët dhe adoleshentët nga 6 deri në 17 vjeç
- Doza juaj normalisht do të jetë midis 0.5 mg dhe 3 mg çdo ditë.
- Adoleshentët deri në 17 vjeç që trajtohen për skizofreni ose probleme të sjelljes mund të kenë një dozë më të lartë, deri në 5 mg çdo ditë.

Si merret Haloperidol
Haloperidol është për përdorim nga goja.
Ju mund ta përzieni tretësirën Haloperidol me pak ujë para se ta merrni, por mos e përzieni me ndonjë lëng tjetër.

Në qoftë se merrni më shumë Haloperidol sesa duhet
Në qoftë se merrni më shumë Haloperidol nga sa ju është thënë ose nëse dikush tjetër ka marrë Haloperidol, njoftoni një mjek ose shkoni menjëherë në spital.

Në qoftë se harroni të merrni Haloperidol
Në qoftë se harroni të merrni një dozë, merrni dozën tuaj të rradhës si zakonisht. Më pas vazhdoni të merrni barin ashtu siç ju ka thënë mjeku.
Mos merrni një dozë të dyfishtë.

Në qoftë se ndërprisni Haloperidol
Nëse mjeku nuk ju rekomandon ndryshe, marrja e Haloperidol do të ndërpritet gradualisht. Nëse mjekimi ndërpritet menjëherë mund të shkaktojë efekte të tilla si:
- të përziera dhe të vjella;
- vështirësi për të fjetur.

Ndiqni gjithmonë me kujdes udhëzimet e mjekut.
Nëse keni ndonjë pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij bari, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME
Si të gjitha barnat e tjera, ky bar mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston.

Tregoni kujdes për efektet anësore serioze
Njoftoni menjëherë mjekun nëse vëreni ose dyshoni për ndonjë nga efektet e mëposhtëm sepse mund t'ju duhet një trajtim mjekësor shumë i shpejtë.

Probleme me zemrën:
- ritëm jonormal i zemrës - zemra nuk funksionon më normalisht dhe mund të shkaktojë humbje të vetëdijes;
- rrahje të shpejta, anormale të zemrës;
- ekstrasistola.

Problemet me zemrën janë të pazakonta tek njerëzit që marrin Haloperidol (mund të prekin deri në 1 në 100 persona). Vdekjet e papritura kanë ndodhur në pacientët që marrin haloperidol, por frekuenca e saktë e këtyre vdekjeve nuk dihet. Arresti kardiak (kur zemra ndalon së rrahuri) gjithashtu ka ndodhur tek njerëzit që marrin barna antipsikotike.

Një problem serioz i quajtur 'sindroma neuroleptike malinje', e cila shkakton temperaturë të lartë, ngurtësim të theksuar të muskujve, konfuzion dhe humbje të vetëdijes. Është e rrallë tek njerëzit që marrin Haloperidol (mund të prekë deri në 1 në 1,000 persona).

Probleme në kontrollin e lëvizjeve të trupit ose të gjymtyrëve (çrregullim ekstrapiramidal), siç janë:
- lëvizjet e gojës, gjuhës, nofullës dhe ndonjëherë të gjymtyrëve (diskinezia tardive);
- ndjenjë shqetësimi, vështirësi për të qëndruar ulur ose lëvizje të shtuara të trupit;
- lëvizje të ngadalta ose të reduktuara të trupit, lëvizje të çrregullta;
- dridhje ose ngurtësim të muskujve, ecje duke tërhequr këmbët zvarrë;
- paaftësi për të lëvizur;
- mungesë e shprehisë normale të fytyrës që ndonjëherë duket si maskë.

Këto janë shumë të zakonshme tek njerëzit që marrin Haloperidol (mund të prekin më shumë se 1 në 10 persona). Nëse keni ndonjë nga këto efekte, mund t'ju jepet një mjekim shtesë.

Reaksion alergjik i rëndë që mund të përfshijë:
- enjtje të fytyrës, buzëve, gojës, gjuhës ose fytit;
- vështirësi në gëlltitje ose frymëmarrje;
- skuqje dhe kruarje të lëkurës (urtikarie).

Reaksioni alergjik është i pazakontë në njerëzit që marrin Haloperidol (mund të prekë deri në 1 në 100 persona).

Mpiksja e gjakut në vena, zakonisht në këmbë (tromboza e venave të thella ose DVT). Ky efekt është raportuar tek njerëzit që marrin barna antipsikotike. Shenjat e një DVT në këmbë përfshijnë: enjtje, dhimbje dhe skuqje në këmbë, por trombi mund të lëvizë në mushkëri duke shkaktuar dhimbje në gjoks dhe vështirësi në frymëmarrje. Trombet e gjakut mund të jenë shumë serioze, kështu që njoftoni menjëherë mjekun nëse vëreni ndonjë nga këto probleme.

Njoftoni mjekun menjëherë nëse vëreni ndonjë nga efektet anësore serioze të mësipërme.

Efektet e tjera anësore
Njoftoni mjekun nëse vëreni ose dyshoni për ndonjë nga efektet anësore të mëposhtme:

Shumë të zakonshme (mund të prekin më shumë se 1 në 10 persona):
- axhitim;
- pagjumësi;
- dhimbje koke.

Të zakonshme (mund të prekin deri në 1 në 10 persona):
- probleme serioze të shëndetit mendor, siç janë besimi i gjërave që nuk janë të vërteta (deluzione) ose të shikuarit, të ndjerit, të dëgjuarit ose të nuhaturit e gjërave që nuk janë aty (haluçinacione);
- depresion;
- tonus anormal i muskujve;
- marramendje, përfshirë gjatë ngritjes nga pozicioni shtrirë në atë ulur ose gjatë ngritjes në këmbë;
- përgjumje;
- lëvizje lart e syve ose lëvizje të shpejta të syve që nuk mund t'i kontrolloni;
- probleme me shikimin, siç është shikimi i paqartë;
- presion i ulët i gjakut;
- të përziera, të vjella;
- kapsllëk;
- tharje goje ose shtim i prodhimit të pështymës;
- skuqje e lëkurës;
- pamundësi për të urinuar ose për të zbrazur fshikëzën plotësisht;
- vështirësi për të arritur dhe mbajtur një ereksion (impotencë);
- shtim ose humbje në peshë;
- ndryshime që shfaqen në analizat e mëlçisë.

Të pazakonta (mund të prekin deri në 1 në 100 persona):
- efekte në qelizat e gjakut – ulje e numrit të të gjitha llojeve të qelizave të gjakut, duke përfshirë ulje të theksuar të qelizave të bardha të gjakut dhe ulje të numrit të trombociteve (qelizat që ndihmojnë në mpiksjen e gjakut);
- konfuzion;
- mungesë ose ulje e dëshirës seksuale;
- kriza epileptike;
- ngurtësim i muskujve dhe kyçeve;
- spazma muskulare, kontraktime që nuk mund t'i kontrolloni si dhe spazëm të qafës e cila shkakton animin e kokës në njërën anë;
- vështirësi në ecje;
- marrje fryme;
- inflamacion i mëlçisë, ose probleme të mëlçisë që shkaktojnë zverdhjen e lëkurës ose syve (ikter);
- rritje e ndjeshmërisë së lëkurës ndaj dritës së diellit;
- kruarje;
- djersitje e tepërt;
- ndryshime në ciklin menstrual (periodat), të tilla si mungesë periodash, ose perioda të gjata, të vrullshme, të dhimbshme;
- prodhimi i papritur i qumështit të gjirit;
- dhimbje gjiri ose diskomfort;
- temperaturë e lartë e trupit;
- enjtje e shkaktuar nga grumbullimi i lëngjeve në trup.

Të rralla (mund të prekin deri në 1 në 1,000 persona):
- nivel i lartë i hormonit 'prolaktinë' në gjak;
- ngushtim i rrugëve të frymëmarrjes në mushkëri, duke shkaktuar vështirësi në frymëmarrje;
- vështirësi ose paaftësi për të hapur gojën;
- probleme gjatë seksit.

Efekte anësore me frekuencë të panjohur
- rritje e nivelit të hormonit antidiuretik në gjak (sindroma e sekretimit të papërshtatshëm të hormonit antidiuretik);
- nivel i ulët i sheqerit në gjak;
- enjtje ose spazëm e kordave zanore, të cilat mund të shkaktojnë vështirësi në të folur ose në frymëmarrje;
- mosfunksionim i papritur i mëlçisë;
- ulje e rrjedhjes biliare në kanalin biliar;
- rrjepie e lëkurës;
- inflamacion i enëve të vogla të gjakut, që çon në skuqje të lëkurës me gunga të vogla, të kuqe ose vjollcë;
- shkatërrim i indit muskulor (rabdomiolizë);
- ereksion i vazhdueshëm dhe i dhimbshëm;
- zmadhim i gjirit tek burrat;
- ulje e temperaturës së trupit.

5. SI TA RUANI HALOPERIDOL
Mbajeni larg fëmijëve!
Ruajeni në temperaturë nën 25°C!
Përpara përdorimit shikoni datën e skadencës e cila është e shënuar në paketim!
Ruajeni nga drita dhe nga lagështia!

6. INFORMACION I MËTEJSHËM
Çfarë përmban Haloperidol – Tretësirë me pika për gojë
Lënda vepruese është haloperidoli.
1 ml tretësirë me pika për gojë përmban 2 mg haloperidol.
Përbërës të tjerë: metil hidroksibenzoat (nipaginë), propil hidroksibenzoat (nipazol), acid laktik dhe ujë i pastruar.

Përmbajtja e paketimit
Kuti me një shishe plastike pikatore 10 ml.

Shpjegues i ikonave ilustruese për paketim:

Merret me recetën e mjekut.

Përmbajtja. Kujdes.

Pika për gojë.

Marketing Authorisation Holder (MAH) and manufacturer:

PROFARMA Sh.a.
Rruga "Myslym Keta"
Tel.: 00355 4 23 89 602
Tiranë - SHQIPËRI

Ky fletëudhëzues u rishikua për herë të fundit në Nëntor 2019.

SPECIFICATION

CROPING AREA 17.5 x 32.5 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible. If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.